



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2266/2 prot

Datë 18.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. **LOT 2 REF-78046-08-22-2023**, me objekt: “**Loti 2** Makineri kompjuterike dhe zyrash, pajisje dhe furnizime përjashtuar mobiljet dhe paketat softëare” me fond limit me fond limit 2.571.250 (dymilion e peseqinde shahtedhjet e nje mije e dyqind e pesedhjetë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Komunitare Per Persona me Aftesi te Kufizuara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK me NIPT K71903025A me adresë Rruga Vaso Pasha, P.2, Shk.2, Ap. 7/1, kati i dytë, Turanë.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Komunitare Per Persona me Aftesi te Kufizuara me adresëv Rruga “Dritan Hoxha”, Njesia Administrative nr.11 Laprake Tirane
- Subjekte të Interesuara:** “RO-AL” SHPK me NIPT J61811001M dhe me adresë Kashar, KM.8, Autostrada Tiranë-Durrës

Në datën 16.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3421 dhe me nr. 2266/2023 prot., datë 18.09.2023 e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK me anë të ankesës me nr. 2266 protokollin, datë 18.09.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK të kriterit si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT (LOTI 2)

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës limit të lotit që prokurohet / shumatores të loteve në të cilat merr pjesë”.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me Çertifikatën ISO 9001: 2015 “Per sistemin e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente.

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 18.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Nënkryetar

Kreshnik Ternova

Fiorent Zguro

Kryetar

Jonaid Myzyri